




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

KORÇË



Nr. 324/789 Akti
Datë regjistrimi 28.02.2022

Datë 11.01.2022

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar: Njesia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.

Për shtetasin: Tomor Duda, banues në fshatin Zvirinë, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtar **Seladin Pysqyli**, asistuar nga sekretare Vitoria Hajçe, në gjykatë, sot më datë **11.01.2023**, përfundoi gjykimin e çështjes civile me nr. *Vendimi 19*, me palë dhe objekt:

PADITËSE: Sofia Nuni, e bija e Minella dhe Lefterie, e datëlindjes 25.05.1981, lindur në fshatin Zvirinë dhe banuese në fshatin Rëmbec, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq, përfaqësuar nga avokat Mateo Balli, antar i Dhomës Vendore të Avokatisë Korçë.

IPADITUR: Tomor Duda, i biri i Dehar dhe Manushaqe, i datëlindjes 1971, lindur në fshatin Kakaç, Bashkia Maliq, dhe banues në fshatin Zvirinë, Njësia Administrative Pojan, Bashkia Maliq.

OBJEKTI: 1-Dhënien e autorizimit paditëses Sofia Nuni për të zhvendosur jashtë vendit (territorit shqiptar) fëmijën Andi Duda i datëlindjes 01.07.2007.

2-Ndryshimin e vendimit nr.439, datë 22.04.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, në lidhje me mënyrën e takimit të të paditurit Tomor Duda me fëmijën Andi Duda.

Baza ligjore: Nenet 58, 159, 220 e 221 të K. Familjes dhe ligjin 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të paditëses dhe në mungesë të të paditurit, përfaqësuesi i paditëses kërkoi pranimin e padisë në lidhje me kërkimin e parë për dhënie autorizimi dhe hoqi dorë nga gjykimi në lidhje me kërkimin e dytë me objekt ndryshimin e vendimit nr.439, datë 22.04.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë,

Gjykata, pasi dëgjoi palën paditëse, analizoi provat dhe morri mendimin e fëmijës dhe të psikologes,

VENDOSI:

1-Pranimin e pjeshëm të padisë, duke autorizuar paditësen Sofia Nuni të zhvendosë jashtë vendit (territorit shqiptar), në Greqi apo në çdo vend tjetër, fëmijën Andi Duda, i biri i Tomor dhe Sofia, i datëlindjes 01.07.2007, duke kaluar nëpërmjet pikave të kalimit kufitar dhe ta përfaqësojë fëmijën pa u marrë pëlqimi i babait të fëmijës, të paditurit Tomor Duda.

2-Pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimin me objekt ndryshimin e vendimit nr.439, datë 22.04.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, përse i takon të drejtës së takimit të të paditurit me fëmijën.

3-Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë kryer.



Nr. 08 Prot

Nj. A. Pojan.
E. tel. Informacionit.
dt. 13.01.2023

4-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 15 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

5-U shpall në Korçë, sot më datë 11.01.2023.

SEKRETARE
Vitoria HAJÇE



Shënim: Kjo shpallje do të qëndroje e afishuar në vendet e mësipërme minimalisht 20 (njëzet ditë) nga data e afishimit.

Shpallja do t'iu dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave duhet të përcillet në gjykatë, menjëherë pas afishimit.

Shpallja u publikua sot në datë _____

Për Rajonin _____

(emër, mbiemër, firmë)